



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**VENDIM**

Nr.124, datë 29.05.2023

**PËR**

**“CAKTIMIN E ZONJËS ALMA FELAJ NË DETYRËN E PROKURORIT NË  
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË  
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, NËPËRMJET  
PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 90, pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 41 dhe 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164, pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 44 dhe 45 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Caktimin e zonjës Alma Felaj në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin vakant Nr.3, shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.332, datë 19.12.2022.
2. Relacioni i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurorja Alma Felaj, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi më datë 05.06.2023 dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 29.05.2023.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR**  
Alfred Balla

**ZV/KRYETAR**  
Tartar Bazaj

**ANËTAR**  
Sokol Stojani

**ANËTAR**  
Bujar Sheshi

**ANËTAR**  
Nurihan Seiti



ANËTAR  
Eloida Goxhi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Mirëla Bogdani

ANËTAR  
Arta Mandro

ANËTAR  
Ledina Riza

